



European
Union
Kosovo

Strategjia kombëtare për zhvillim: arritjet, ngecjet dhe pritjet për të ardhmen

Prill 2021



KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Strategjia kombëtare për zhvillim: arritjet, ngeçjet dhe pritjet për të ardhmen


Prill 2021

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

— Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Vlerësimi i synimeve	4
2.1 Rritja Ekonomike	4
2.2 Tregu i punës	6
2.3 Investimet e huaja direkte dhe tregtia	10
3. Përfundim	11



1. Hyrje

Në shtator të vitit 2020, Qeveria e Kosovës kishte publikuar konceptin për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2030¹, ndërsa në tetor kishte marrë vendim për hartimin e kësaj strategjie.² Strategjia e cila do të krijohet pas kalimit nëpër disa faza, synon të vë objektiva afatgjata rreth sundimit të ligjit, zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor, dhe anëtarësimin të vendit në Bashkimin Evropian. Duke qenë dokument strategjik për planifikim afatgjatë, pritet që të gjitha strategjitë vijuese sektoriale dhe planet operative të derivojnë dhe të jenë në vijë me objektivat e saj.

Mirëpo, meqë Kosova kishte hartuar një strategji të tillë në vitin 2016 dhe e cila ende është në fuqi, konkretisht SKZH 2016–2021, mbetet e rëndësishme të analizohet se cilat janë rezultatet e arritura deri më tani lidhur me objektivat e strategjisë. Në rast se ky dokument është konsideruar me peshë nga qeveritë e kaluara, që t'i ndërtojnë politikat e tyre në vijë me qëllimet e vendosura në strategji, atëherë vlerësimi do të duhej të tregonte shkallë më të lartë të performancës së treguesve kryesorë për matjen e objektivave.

Në prill të vitit 2017, ishte miratuar udhërrëfyshi për zbatimin e SKZH 2016–2021, ku përcaktoheshin planet për arritjen e objektivave, vlerësimi i kostos së masave, treguesit kryesorë për matjen e rezultateve dhe sistemi i monitorimit të SKZH-së.³ Udhërrëfyshi i lartëcekur mbetet një dokument tejet i rëndësishëm meqë arrin të dizajnojë skemën me të gjitha hallkat dhe operacionet, përfshirë këtu sistemet, që duhet të ndërveprojnë në mënyrë që zbatimi i masave të jetë i suksesshëm. Por, ndonëse ky udhërrëfyes parashihte edhe monitorim dhe raportim rreth planit operacional dhe përmbushjes së masave në baza gjashtë mujore dhe vjetore, respektivisht, raporti i parë dhe i vetëm i monitorimit të SKZH-së ishte hartuar në tetor të vitit 2018.⁴

Instituti GAP ka vlerësuar arritjen e objektivave bazuar në një monitorim të performancës së 12 treguesve kryesorë makroekonomikë, që ishin zgjedhur për të vlerësuar suksesin e zbatimit të masave dhe arritjes së objektivave të SKZH 2016–2021. Nga ky monitorim vërehet se arritjet janë të pakta duke përfshirë këtu ngecjen për shkallë më të lartë të rritjes ekonomike, punësimin, përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e investimeve të huaja direkte. Si rezultat, arritja e shumicës së objektivave gjatë vitit 2021, edhe sikur të mos ndodhte pandemia COVID-19 gjatë vitit 2020, do të ishte thuajse e pamundur. Ndërrimi i pesë qeverive gjatë pesë viteve të zbatimit të kësaj strategjie, ku politikat qeverisëse të secilës ishin të ndryshme, mos vlerësimi sistematik i përmbushjes së masave të SKZH-së dhe planifikimet e pa analizuara mirë, janë disa nga arsyet e mos përmbushjes së objektivave kyçe.

1 Qeveria e Kosovës. Koncepti për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030. Burimi: <https://bit.ly/3tzJoRL>

2 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr. 15/34 për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030. Burimi: <https://bit.ly/3oR7l15>

3 Qeveria e Kosovës. Udhërrëfyshi për zbatimin e SKZH 2016–2021. Burimi: <http://bit.ly/3eBrvhi>

4 Qeveria e Kosovës. Raporti i parë për zbatimin dhe rezultatet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021. Burimi: <https://bit.ly/3c67r55>

2. Vlerësimi i synimeve

2.1 Rritja Ekonomike

2.1.1 Bruto Produkti Vendor për kokë banori

Një ndër caqet më të rëndësishme ekonomike të synuara në SKZH 2016-2021 është Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori. BPV është një tregues gjithpërfshirës i ecurisë së ekonomisë gjatë një periudhe kohore i cili pëmbledh prodhimin ose të ardhurat totale vendore. Ndërsa, BPV për kokë banori pasqyron pjesëmarrjen mesatare të qytetarëve në këto të ardhura dhe ndërlidhet me mirëqenien ekonomike.

Më 2015, BPV vjetor për kokë banori ishte 3,277 euro, ndërsa në SKZH synohej që deri më 2021 të arrijë në 5 mijë euro. Për t'u realizuar kjo shumë, ky tregues do të duhej të rritej për mesatarisht 8.5% në vit, ndërkaq rritja mesatare nga 2016 deri më 2019 ishte 5%. Me këtë trend, gjatë periudhës 2020 dhe 2021, rritja e BPV për kokë banori duhet të jetë mesatarisht rreth 12% në vit në mënyrë që të realizohet synimi. Megjithëse të dhënat për vitin 2020 nuk janë publikuar ende, marrë parasysh zhvillimin ekonomik të deritanishëm dhe gjendjen e rëndë ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19, është e qartë se ky cak, përkundër rritjes së lehtë, nuk ka arritur synimet e parashikuara.

Tabela 1. Bruto Produktin Vendor për kokë banori dhe caku i SKZH-së 2016-2021

	Baza (2015)	2016	2017	2018	2019	Përmirësimi i nevojshëm në 2020 (mesatare)*	Përmirësimi i nevojshëm në 2021 (mesatare)*	Vlera e synuar (2021)
BPV për kokë banori (€)	3,277	3,386	3,566	3,746	3,986	4.464 ▲ 12% prej 3,986	5.000 ▲ 12% prej 4,464	5.000

*Kalkulim i Institutit GAP

Programet dhe reformat ekonomike të synuara në SKZH nuk kanë treguar rezultate pozitive të mjaftueshme për të përmbushur cakun e synuar. Madje marrë parasysh rënien e BPV-së në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2020, ky tregues ekonomik pritet të jetë larg parashikimeve.

2.1.2 Norma reale vjetore e rritjes së BPV-së

Me arritje të kufizuar është vlerësuar edhe norma reale e BPV-së. Në vitin 2015, rritja reale ishte 4.1% ndërsa me reforma ekonomike ky trend synohej të arrinte rritje mesatare vjetore prej 7% në vitin 2021. Që të arrihet ky synim, norma e rritjes për vit duhet të jetë rreth 1.05 pikë përqindje (p.p.) mbi normën e vitit 2019 apo 5.95% në vitin 2020. Megjithatë, edhe duke anashkaluar vitin 2020 në të cilin pritet të ketë rënie ekonomike, ky target nuk është arritur. Norma mesatare e rritjes nga 2015 deri më 2019 ishte rreth 4.2% apo 2.8 p.p. më ulët se caku i synuar. Për këtë arsye edhe ky tregues ekonomik i vendosur në SKZH është vlerësuar me progres të kufizuar.

Tabela 2. Norma reale e rritjes së BPV-së dhe caku i SKZH-së 2016-2021

	Baza (2015)	2016	2017	2018	2019	Përmirësimi i nevojshëm në 2020 (mesatare)*	Përmirësimi i nevojshëm në 2021 (mesatare)*	Vlera e synuar (2021)
Norma reale e rritjes së BPV-së	4.1%	4.1%	4.2%	3.8%	4.9%	5.95% (1.05 p.p. ose 21.4% ▲ prej 4.9%)	7% (1.05 p.p. ose 17.6% ▲ prej 5.95%)	7%

*Kalkulim i Institutit GAP

2.1.3 Formimi i bruto kapitalit fiks si përqindje e BPV

Në anën tjetër, formimi i bruto kapitalit fiks⁵ si përqindje e BPV-së ka shënuar progres nga viti 2015 për mesatarisht 0.9 p.p. në vit. Kjo ka bërë që më 2019 ky tregues të jetë 3.4 pikë përqindje aftër caktut të synar. Ky progres është arritur si rezultat i rritjes së formimit të bruto kapitalit më shumë se komponentët e tjerë që përbëjnë BPV-në. Megjithatë për t'u përmbushur synimi i plotë i paraqitur në SKZH, ky tregues duhet të rritet për 1.7 p.p. në vit apo 30.3% në 2020 dhe 32% në 2021. Kjo rritje është vështirë e mundshme marrë parasysh trendet e viteve të kaluara.


Tabela 3. Formimi i bruto kapitalit fiks si përqindje e BPV-së dhe caku i SKZH-së 2016-2021

	Baza (2015)	2016	2017	2018	2019	Përmirësimi i nevojshëm në 2020 (mesatare)*	Përmirësimi i nevojshëm në 2021 (mesatare)*	Vlera e synuar (2021)
Formimi i bruto kapitalit fiks (% e BPV)	25%	26.6%	25.9%	27.5%	28.6%	30.3% (1.7 p.p. ose 5.9% ▲ prej 28.6%)	32% (1.7 p.p. ose 5.6% ▲ prej 30.3%)	32%

*Kalkulim i Institutit GAP

BPV për kokë banori dhe norma reale e BPV-së janë treguesit më gjithpërfshirës të performancës së ekonomisë. Mungesa e arritjes së caktut të synuar në SKZH për këta indikatorë tregon për ngecje të reformave të parapara për arritjen e këtyre synimeve. Parametrat e synuara nuk janë arritur në asnjë vit nga viti 2015.

5 Formimi i Kapitalit Bruto përfshin investimet e bizneseve për blerjen e makinerive të prodhimit ose në akumulimin e inventarit dhe blerja e një shtëpie të re nga ekonomitë familjare e cila në BPV konsiderohet si investim e jo konsum.

Figura 1. Treguesit kryesor të rritjes ekonomike dhe caqet e SKZH-së 2016-2020

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK)

2.2 Tregu i punës

Ndër 15 treguesit kryesorë makroekonomikë që janë zgjedhur për të vlerësuar progresin e bërë në kuadër SKZH-së, gjashtë janë tregues që ndërlidhen me tregun e punës. Përmirësimi i tyre ndër vite, pra arritja e vlerave të synuara, tregon edhe efektshmërinë e masave dhe politikave të ndërmarra në kuadër të SKZH-së për reformim të tregut të punës.

2.2.1 Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe punësimit

Deri në fund të vitit 2019, vit ky me të cilin do të bëhen kryesisht krahasimet meqë pandemia COVID-19 gjatë vitit 2020 ka pasur ndikim të drejtpërdrejt negativ në indikatorët e punësimit, progres më të konsiderueshëm krahasuar me treguesit tjerë kishin treguesi i shkallës së pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkalla e punësimit. Pjesëmarrja e fuqisë punëtore kishte arritur vlerën prej 40.5% apo 1.5 p.p. (3.7%) larg vlerës së synuar (42%) për vitin 2021, ndërsa shkalla e punësimit ishte rritur në 30.1% apo 3.9 p.p. (12.96%) larg vlerës së synuar (34%). Nëse e supozojmë një situatë për vitin 2020 pa prezencë të pandemisë, sipas kalkulimeve të GAP, treguesi i shkallës së pjesëmarrjes në fuqi punëtore do të mund të arrinte vlerën e synuar gjatë vitit 2021, nëse në periudhën 2020-2021 do të kishte rritje prej mbi 1.8% apo 0.75 p.p. nëse cilin vit. Kjo rritje do të duhej të ishte më e lartë se rritja mesatare vjetore gjatë periudhës 2015-2019 prej 0.73 p.p. ndonëse shumë e përafërt. Ndërsa shkalla e punësimit, për të arritur vlerën e synuar në vitin 2021 do të duhej të kishte rritje mesatare gjatë viteve 2020 dhe 2021 me mbi 6% apo rreth 2 p.p.. Rritja mesatare vjetore e këtij treguesi në periudhën 2015-2019 ishte vetëm 1.23 pikë përqindje. Pandemia COVID-19 e ka shtyer edhe më larg arritjen e këtyre objektivave, meqë punësimi gjatë vitit 2020 ka pësuar rënie.

Tabela 4. Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe punësimit dhe caku i SKZH-së 2016-2021

	2015	2016	2017	2018	2019	Përmirësimi i nevojshëm në 2020 (mesatare)*	Përmirësimi i nevojshëm në 2021 (mesatare)*	Vlera e synuar (2021)
Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore (% e gjithsej popullsisë 15+ vjeç)	37.6%	38.7%	42.8%	40.9%	40.5%	41.25% ▲ prej 1.85%	42% ▲ prej 1.82%	42%
Shkalla e punësimit (raporti punësim-popullsi)	25.2%	25.5%	27.3%	28.8%	30.1%	32.05% ▲ prej 6.48%	34% ▲ prej 6.08%	34%

*Kalkulim i Institutit GAP

2.2.2 Shkalla e papunësisë dhe papunësia tek të rinjtë

Devijimin më të madh nga vlera e synuar për vitin 2021 e ka ulja e papunësisë tek të rinjtë në 30% deri më 2021. Qëllimi që përmes një ndërlidhjeje të planprogrameve mësimore me kërkesat e tregut, krijimit të një ambienti të mirë për investime dhe investimeve në edukim do të krijoheshin më shumë vende pune dhe mundësi më të mëdha për punësim, nuk është arritur meqë rezultatet kanë munguar nëse cilin vit. Në vitin 2019, shkalla e papunësisë tek të rinjtë ishte 49.4%, në vitin 2018 ishte 55.4%, ndërsa edhe në vitet paraprake ishte mbi 52%. Ngjashëm, edhe treguesi rreth përqindjes së të rinjve që nuk janë të përfshirë qoftë në tregun e punës, shkollim apo trajnime, gjatë vitit 2019 kishte devijim prej 7.7 p.p. nga vlera e synuar prej 25%. Për shkak se situata e të rinjve pjesë e këtij grupi veçse është përkeqësuar viteve të fundit, sidomos në periudhën 2018-2019, kur ishte rritur numri i të rinjve jashtë tregut të punës apo ndjekjes së ndonjë trajnimit, edhe në mungesë të pandemisë, ky tregues do të duhej të përmirësohej gjatë viteve 2020 dhe 2021 për rreth 12% në mënyrë që të arrihej vlera e synuar. Në periudhën 2015-2019, ky tregues në mesatare kishte përkeqësim, pra rritje të të rinjve jashtë tregut të punës apo edukimit.

Edhe shkalla e papunësisë së përgjithshme në Kosovë, në vitin 2019 kishte shmangie nga vlera e synuar për vitin 2021 për 5.7 p.p. apo 22.2%. Realisht ky indikator kishte përmirësim të vazhdueshëm gjatë viteve 2015-2019 me një mesatare prej 1.8 p.p. në baza vjetore, mirëpo për tu arritur vlera e synuar prej 20% të papunë, progresi në vitet 2020 dhe 2021 do të duhej të ishte tejet i madh edhe nëse e supozojmë një skenar pa prezencë të pandemisë COVID-19. Konkretisht, do të duhet të ndodhte njëulje mesatare prej rreth 12% apo 2.85 p.p. në të dy vitet, 2020 dhe 2021.

Andaj, arritja e vlerave të synuara për këta tregues gjatë vitit 2021 do të ishte me shumë pak gjasë që të ndodhte.

Tabela 5. Shkalla e papunësisë, mospërfshirjes në arsim, trajnim dhe punësim, dhe papunësia tek të rinjtë dhe caku i SKZH-së 2016-2021

	2015	2016	2017	2018	2019	Përmirësimi i nevojshëm në 2020 (mesatare)*	Përmirësimi i nevojshëm në 2021 (mesatare)*	Vlera e synuar (2021)
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	57.7%	52.4%	52.7%	55.4%	49.4%	39.7% ▲ prej 19.64%	30% ▲ prej 24.43%	30%
Përqindja e të rinjve që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim ose trajnim, totali, NEET (% e popullsisë së të rinjve)	31.4%	30.1%	27.4%	30.1%	32.7%	28.85% ▲ prej 11.77%	25% ▲ prej 13.34%	25%
Shkalla e papunësisë (totali i të papunëve si % e totalit të fuqisë punëtore)	32.9%	27.5%	30.5%	29.6%	25.7%	22.85% ▲ prej 11.09%	20% ▲ prej 12.47%	20%

*Kalkulim i Institutit GAP

2.2.3 Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore

Shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore mbetet në nivel të padëshiruar, ku vetëm një e pesta e tyre në moshë pune gjatë vitit 2019 ishte pjesë e tregut të punës, rrjedhimisht si të punësuar apo punëkërkuese të regjistruara. Ndonëse vlera e synuar për vitin 2021 ishte 27%, rritja e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore në këtë përqindje, bazuar në trendin e rritjes së saj nga viti 2015 deri në 2019, do të ishte thuajse e pamundur edhe në mungesë të pandemisë COVID-19. Konkretisht, gjatë viteve 2020 dhe 2021, do të duhej të ndodhte një rritje prej mbi 12% apo rreth 3 p.p. në secilin vit në mënyrë që të arrihej ky target, ndërsa rritja mesatare vjetore ndër vite ishte vetëm 0.75 p.p.. Ndërsa vetë pandemia COVID-19, siç tregojnë edhe gjetjet e raporteve, ka rënduar edhe më shumë gjendjen e grave në tregun e punës për shkak edhe të rritjes së punëve tjera të papaguara gjatë kohës së karantinimit.⁶


Tabela 6. Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore dhe caku i SKZH-së 2016-2021

	2015	2016	2017	2018	2019	Përmirësimi i nevojshëm në 2020 (mesatare)*	Përmirësimi i nevojshëm në 2021 (mesatare)*	Vlera e synuar (2021)
Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore nga radhët e grave (% e gjithsej popullsisë 15+ vjeç)	18.1%	18.6%	20.0%	18.4%	21.1%	24.05% ▲ prej 13.98%	27% ▲ prej 12.27%	27%

*Kalkulim i Institutit GAP

Performanca jo e mirë e treguesve kyç të tregut të punës dhe shmangia e theksuar nga qëllimii synuar, vë kryesisht në pah mungesën e reformave dhe politikave adekuate të qeverive të Kosovës ndër vite për rritjen e cilësisë në arsim dhe ndërlidhjen e arsimit me nevojat e tregut të punës, si dhe për të krijuar kushte për zhvillim ekonomik dhe një ambient më të favorshëm për kyçjen e grave në tregun e punës.

Figura 2. Vlerësimi i treguesve makroekonomikë në kuadër të SKZH-së 2016-2021



*2020 / 2021 - Synuar

2.3 Investimet e huaja direkte dhe tregtia

2.3.1 Investimet e huaja direkte

Dy indikatorë tjerë të rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe të paraqitur në SKZH janë investimet dhe tregtia. Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë kapitali i huaj që investohet në Kosovë. Këto të hyra ndihmojnë rritjen e BPV-së dhe performancën e përgjithshme ekonomike. Në vitin 2015, investimet e huaja ishin rreth 309 milionë euro ndërsa projeksionet e vendosura në SKZH synonin arritjen e 600 milionë eurove në vitin 2021. Për realizimin e kësaj shume u supozuan reforma të ndryshme të tërheqjes së investimeve të huaja direkte përfshirë lehtësira procedurale në investimin e kapitalit të huaj, përmirësimin e efikasitetit të gjykatave për trajtimin e çështjeve ekonomike dhe thellimin e mardhënieve ndërkombëtare për tregti.

Mirëpo, përkundër trendit pozitiv, të dhënat e IHD-ve tregojnë se nga viti 2016 deri në 2018, kishte rënie të investimeve të huaja direkte krahasuar me vitin bazë (2015). Në vitin 2020 kishte rritje të IHD-ve në 321.7 milionë. Megjithatë, përkundër kësaj, indikatori i synuar i IHD-ve qëndron rreth 86.5% larg realizimit të caktuar të synuar në SKZH.

Tabela 7. Investimet e huaja direkte dhe caku i SKZH-së 2016-2021

Treguesi	Baza (2015)	2016	2017	2018	2019	2020	Përmirësimi i nevojshëm në 2021 (mesatare)*	Vlera e synuar (2021)
Hyrjet e të IHD-ve (milion €)	308.8	220	255.4	272.1	254.6	321.7	600 ▲ 86.5% prej 321.7	600

*Kalkulim i Institutit GAP

2.3.2 Raporti tregtar dhe eksportet si përqindje e BPV

Sa i përket raportit tregtar, eksporti ka realizuar rritje më të lartë se ajo që është parashikuar në SKZH. Përqindja e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në BPV është synuar të jetë rreth 28% në vitin 2021 nga 19.3% sa ishte në vitin 2015. Ndërsa deri në vitin 2019 kjo përqindje ka arritur vlerën e 29.5% që është 1.5 p.p. më e lartë se caku i synuar në SKZH. Performanca e mirë e eksporteve ndërlidhet kryesisht me shërbimet. Viteve të fundit, Kosova ka realizuar bilanc pozitiv sa i përket shërbimeve, ndërsa thellim të deficitit tregtar sa i përket mallrave. Për këtë arsye, treguesi tjetër i vendosur në SKZH që matë ecurinë e raportit të eksportit dhe importit të mallrave ka shënuar regres. Krahasuar me vitin bazë, në vitin 2019 ky raport ka pësuar rënie për 0.6 p.p. dhe qëndron larg caktuar të synuar të SKZH për 5.8 p.p.. Rritja e konsumit të brendshëm të mallrave dhe ngecja e zëvendësimit të importit ka thelluar deficitin tregtar në mallra. Prandaj, ky tregues është vlerësuar se nuk ka pasur aspak progres.

Tabela 8. Treguesit tregtar dhe caku i SKZH-së 2016-2021

Treguesi	Baza (2015)	2016	2017	2018	2019	Përmirësimi i nevojshëm në 2021 (mesatare)*	Vlera e synuar (2021)
Raporti eksport-import (mallra)	12.8%	11.7%	13.8%	12.2%	12.2%	18% (2.9 p.p. ose 19.2% ▲ prej 15.1%)	18%
Përqindja e eksporteve në BPV (mallra dhe shërbime)	19.3%	21.6%	26.5%	26.7%	29.5%	-	28%

*Kalkulim i Institutit GAP

3. Përfundim

Rezultatet e vlerësimit të indikatorëve kyç makroekonomikë më lartë tregojnë progres jo të kënaqshëm të Kosovës në raport më synimet e përcaktuara në SKZH 2016-2021. Arsyet për ndikim të kufizuar të masave të SKZH mund të jenë të ndryshme marr parasysh dhe ambientin e paqëndrueshëm politik, ku ndërrimi i qeverive gjatë periudhës 2016-2020 ishte i shpeshtë, mos-koordinimi i politikave të qeverive me masat e përcaktuara në SKZH, dhe mungesa e vlerësimeve sistematike të progresit të masave në kuadër të SKZH-së. Ngecja është më e theksuar sidomos në treguesit kryesorë, sikurse një rritje jo e lartë ekonomike dhe mos krijimi i mundësive për rritje të shkallës së punësimit.

Aktualisht, procesi i përgatitjes së dokumentit të SKZH-së për vitin 2030 planifikohet të kalojë nëpër disa faza. Meqë përgjatë mandatit të qeverisë në ardhje (2021-2025) do të duhej të zbatohet një pjesë e madhe e SKZH 2030, është e rëndësishme që masat e përfshira në strategji të jenë në vijë me orientimet zhvillimore dhe programin e qeverisë në ardhje. Po ashtu, strategjia e re duhet të reflektojë edhe gjendjen e shkaktuar nga pandemia COVID-19, sidomos në ndryshimet që janë shkaktuar qoftë në mënyrën e operimit të sektorëve, nevojës për digjitalizim të shërbimeve dhe bizneseve, dhe shërbime shëndetësore më cilësore dhe gjithëpërfshirëse. Koordinimi mes masave që dalin nga analizat e ndryshme të kryera nga institucionet qendore dhe programit të qeverisë së re, në rastin e Kosovës, marrë parasysh zhvillimin e ulët ekonomik, kapacitetet e dobëta prodhuese, bilancin e dobët tregtar, sektorin e arsimit të pareformuar, do të duhej të ishte proces më i lehtë. Për më shumë, me përditësimet e nevojshme, hierarkia e skemës për implementim të SKZH-së e zhvilluar për strategjinë 2016-2021, ku janë përcaktuar mekanizmat, afatet dhe proceset për implementim të masave dhe monitorim të rezultateve, paraqet një ndihmesë të madhe drejt arritjes së objektivave.


Andaj, mbetet e rëndësishme që:

- Para se të miratohet SKZH 2030, të bëhet një vlerësim i detajshëm i zbatimit të SKZH 2016-2021, konkretisht rreth rezultateve të arritura, shkaqeve të mos arritjes së objektivave të caktuara, problemet që kanë ndikuar në zbatimin e strategjisë dhe mësimet e nxjerra;
- Të bëhet edhe një vlerësim i ndikimit të pandemisë COVID-19 në aspektin ekonomik, social dhe shëndetësor dhe si ajo mund të ndikojë në funksionim e këtyre sektorëve të ardhmen. Këto ndryshime, duhet të reflektohen më pas në kuadër të masave të strategjisë;
- SKZH 2030 të përgatitet në koordinim të institucioneve përgjegjëse për draftim të strategjisë dhe qeverisë së re, në mënyrë që të rritet gjasa për shkallë më të lartë të zbatimit të masave të strategjisë;
- Gjatë zbatimit të SKZH 2030, monitorimi dhe vlerësimi i arritjeve duhet jetë sistematik, në mënyrë që efekti i reformave dhe masave të jetë më i madh. Konkretisht, përditësimi i rezultateve i jap qeverisë një pasqyrë më të mirë rreth angazhimit që duhet bërë për arritjen e objektivave.



European
Union
Kosovo

Projekti “Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar”
i financuar nga BE, implementohet nga:



INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Strategjia kombëtare për zhvillim:
arritjet, ngecjet dhe
pritjet për të ardhmen